

MESAZHI I KRYETARIT TË KOMUNËS

Komuna Velipojë është një nga pesë komunat pilot të përzgjedhura nga Fondi i Zhvillimit Shqiptar (F.ZH.SH) për hartimin e Planit të Zhvillimit Lokal, në kuadrin e programit të rritjes së kapaciteteve të qeverisjes vendore nën Projektin Pnet e Komunitetit II të financuar nga Banka Botërore.

Strategjia Rajonale e Zhvillimit të Qarkut Shkodër, Vendimi nr.682, datë 2.11.2005 i Këshillit të Ministrave që shpall lumin Buna dhe territoret ligatinore rreth tij “Peisazh ujor/tokësor i mbrojtur”, pozita e favorshme gjeografike, bukuria dhe burimet e shumta natyrore, mendoj se do të jenë faktorë favorizues dhe nxitës në zbatimin e Planit të Zhvillimit Lokal të Komunës Velipojë.

Plani i Zhvillimit Lokal do t’i japë një shtysë të re zhvillimit ekonomik dhe social të komunës. Realizimi i objektivave strategjike të përcaktuara në fushat prioritare do të rrisë mirëqënien e komunitetit, do të rrisë besimin e komunitetit të biznesit në qëndrueshmërinë dhe ecurinë e investimeve të tyre, do të rrisë bashkëunimin e banorëve me administratën vendore si dhe do të krijojë premisa për një qeverisje vendore më të mirë në funksion të komunës dhe më gjërë.

Realizimi i hartimit të Planit të Zhvillimit Lokal i cili, zgjati për një periudhë gjashtë mujore, nuk do të kishte qënë i mundur pa mbështetjen e Këshillit të Komunës, të administratës së komunës, të kryepleqve të fshatrave dhe të pjesëmarrjes së gjërë të komunitetit. Grupi i Planifikimit të Zhvillimit Lokal i përbërë nga 20 anëtarë si dhe grupi i Monitorim Vlerësimit me Pjesëmarrje i përbërë nga 9 anëtarë dhanë kontributin dhe kohën e tyre në hartimin e këtij plani. Në panaiet e ideve që u zhvilluan në fshatrat e komunës dhe ku morën pjesë mbi 250 banorë, u dhanë mendime dhe ide mbi objektivat strategjike të fushave prioritare dhe të vizionit të komunës. Realizimi i intervistave me 200 familje të fshatrave të komunës të përzgjedhura në mënyrë rastësore, në lidhje me cilësinë e shërbimeve që ofron komuna, ishin të dhëna të rëndësishme që u përdoren për hartimin e Planit të Zhvillimit Lokal të Komunës Velipojë.

Së fundi, deklaroj se Plani i Zhvillimit Lokal i hartuar, është një plan cilësor dhe ambicioz i cili do t’i shërbejë të ardhmes së komunës Velipojë dhe do të jetë një busull për administratën e komunës.

Dedë KAÇI
Kryetar i Komunës Velipojë

FALENDERIME

Hartimi i këtij plani nuk do të ishte i mundur pa kontributin dhe dedikimin e Këshillit të Komunës dhe të anëtarëve të përmendur më poshtë:

KËSHILLI I KOMUNËS

Muhamet Keçi, Françesk Çeraj, Anton Marku, Luigj Dashi, Zef Ndoci, Gac Prroni, Demush Maleci, Dedë Lami, Lukë Tereze Vukcaj, Nush Marku, Gjovalin Zeka, Agostin Martini, Mark Gjergji, Ramazan Ujka.

KOMUNA VELIPOJË:

Grupi i Planit të Zhvillimit Lokal (PZHL)

Kryetar, (i zgjedhur nga grupi I PZHL) – Dedë Kaçi, Kryetar i Komunës
Antarë të Këshillit të Komunës – Gjovalin Zeka, Gac Prroni
Nëpunës të administratës së komunës – Kanto Gjoka, Gegë Përgjecaj, Zybe Dhima, Gjovalin Bregna, Nard Fsharri, Marash Keçi
Banorë me profesione dhe nga fshtra të ndryshëm të komunës – Lekë Marku, Rrok Frani, Prek Marku, Pjetër Ujka, Leze Hoxhaj, Fili Kërcunga, Nik Dajti, Lek Simoni, Frrok Çera, Prel Miri, Tomë Shyti.

Grupi i Monitorim Vlerësim me Pjesmarrje (MVP)

Kryetar – Muhamet Keçi
Staf i komunës – Agim Hoxhaj, Rikard Malaj, Lekë Blinishi,
Përfaqësues të komunitetit – Fran Lisi, Marsh Bari, Marash Frani, Sandër Viluni, Zekë Deda

Hartimi i Planit të Zhvillimit Lokal u bë i mundur edhe nga bashkëpunimi i frytshëm me Fondin e Zhvillimit Shqiptar (FZSH). Si pjesë e programit të rritjes së kapaciteteve të qeverisjes lokale nën Projektin Pnet e Komunitetit II (të financuar nga Banka Botërore), FZSH përgatiti metodologjinë dhe një strukturë për planifikimin e zhvillimit lokal dhe përzgjedhi komunën tone si komunë pilot për të testuar këtë metodologji. Gjatë punës së saj, FZSH përfshiu Institutin Urban (Ëashington, DC) dhe Institutin e Kërkimeve Urbane (IKU) që të punonte me personelin e FZSH në hartimin e metodologjisë dhe të monitoronte zbatimin. Në vazhdim të kesaj, FZSH nënkontraktoi MixTecnica (Tirana) për të ofruar koordinimin, asistencën teknike dhe monitorimin e procesit të hartimit të Planit të Zhvillimit Lokal në Velipojë.

HYRJE

Gjatë vitit 2005 komuna Velipojë u angazhua në procesin e hartimit të Planit të Zhvillimit Lokal, qëllimi i të cilit ishte përcaktimi i një vizioni të qartë për të ardhmen e komunës dhe të komunitetit si dhe caktimi i hapave të veprimit për arritjen e këtij vizioni.

Hartimi i Planit të Zhvillimit Lokal u realizua me anë të një procesi të hapur dhe transparent duke përfshirë këshillin e komunes, administratën e komunes, grupet e këshillimit dhe të ndjekjes, të krijuara në nivel komune dhe fshati si dhe anëtare të tjerë të komunitetit në krijimin e një vizioni afatgjatë zhvillimi, objektivave strategjike si dhe hapat/projektet konkrete të cilat do të çojnë komunën Velipojë drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Ky plan është pjesë e strategjisë rajonale të zhvillimit të Qarkut Shkodër i cili filloi në 2004, duke patur parasysh objektivat afatgjatë deri në vitin 2015. PZHL është një insiative e re lokale, që nxit aftësitë planifikuese afatgjatë dhe priorizimin e ndërhyrjeve.

Pse duhet të hartojmë një Plan për Zhvillimin Lokal?

Planifikimi i zhvillimit lokal është një proces që i jep mundësinë komunës Velipojë dhe komunitetit të sajë të planifikojnë, zbatojnë dhe kontrollojnë të ardhmen e tyre. Një Plan Zhvillimi Lokal jep informacion mbi drejtimin e veprimeve drejt zhvillimit të një komuniteti. PZHL është një hartë për t'u ndjekur nga të zgjedhurit, administrata e komunës, dhe komuniteti në tërësi për t'i dhënë formë të ardhmes së dëshiruar prej tyre. Planifikimi i Zhvillimit Lokal ka të bëjë me të menduarin, të vepruarin dhe të parishikuarin strategjik të veprimeve që duhet të ndërmarrim në mënyrë që të realizojmë qëllimet e dëshirueshme.

Një plan zhvillimi është efektiv kur në e kuptojmë se çfarë po bëjmë, kujt i shërben, dhe sa mirë i plotëson nevojat e komunitetit. Kur bëhet mirë, planifikimi i zhvillimit lokal ka pjesëmarrjen e gjërë të komunitetit dhe aktoreve të tjerë të interesuar. Kjo garanton që ne po përdorim burimet më të mira të mundshme në planifikimin e së ardhmes ashtu si edhe krijon një forum të gjërë për pjesëmarrje të shoqërisë, përkushtim dhe rritje të ndjenjes së pronësisë.

Qëllimet strategjike dhe hapat e veprimit të shprehura në Planin e Zhvillimit Lokal nuk janë vetëm autoritet i qeverisjes vendore. Komuna nuk mund të bëjë vetë gjithçka, dhe as nuk mund t'i adresojë vetëm të gjitha problemet e komunitetit. Kështu që, në Planin e Zhvillimit Lokal është idea që i gjithë komuniteti ka një kontribut për të dhënë në arritjen e një komune të qëndrueshme. Angazhimi dhe veprimet e komunitetit, grupeve dhe të interesuarëve të tjerë janë mjaft të rëndësishme në arritjen e suksesshme të Vizionit të Komunës, qëllimeve dhe veprimeve që janë themelore në Planet e Zhvillimit Lokal.

Një PZHL është efektiv kur në mënyrë rigoroze përdoret që të planifikojë shërbime dhe projekte, identifikojë burimet, boshllëqet dhe nevojat fiskale, masë rezultatet e punës së qeverisë lokale, dhe ti komunikojë këto rezultate tek komuniteti. Ky është një proces dhe dokument me anë të të cilit komuniteti mund të vërë përpara përgjegjësisë udhëheqësit e tij në mënyrë që ti përgjigjet nevojave dhe prioritetëve të tij. PZHL siguron një përdorim efektiv të burimeve specifike të komunave në mënyrë që të bëhet sa më e mundur arritja e objektivave.

PËR ÇFARË ËSHTË PLANI YNË I ZHVILLIMIT LOKAL?

Një vizion i përbashkët

Komuna Velipojë në realizimin e Planit të Zhvillimit Lokal përballet me shumë sfida, por ka në dispozicion burimet e saja natyrore, forcën aktive për punë, mbështetjen e qarkut dhe të pushtetit qëndror. Detyra e komunës është që të bashkojë të gjitha burimet dhe komunitetin në një vizion të përbashkët për të cilin mund të mobilizojmë dhe të përdorim sa më mirë burimet tona njerëzore, natyrore dhe financiare. Për të arritur këtë, procesi ynë për hartimin e PZHL ftoi këshilltaret dhe komunitetin për "të pikturuar" të ardhmen tonë në 10 – 15 vitet e ardhshme. Rezultati i këtij aktiviteti ishte "Vizioni i Velipojës".

Një plan për të ardhmen tonë

E ardhmja jonë sigurisht që do të jetë ndryshe – dhe duhet të sigurohemi që jemi ne autorë të këtij ndryshimi duke iu kundërvënë situatave rrethanore që përcaktojnë të ardhmen tonë. PZHL përmban qëllime dhe hapa veprimi të realizueshme, për të cilat në jemi të sigurt që mund t'i arrijmë hap pas hapi në rrugën tonë për të përmbushur vizionin.

Katër shtyllat

Ne dëshironim të caktonim një rrjet të gjërë që të siguroheshim që të gjitha prioritetet e zhvillimit të përfshiheshin në PZHL. Kjo ishte arsyeja që e organizuam PZHL në bazë të katër fushave prioritare:

- Zhvillimi Ekonomik
- Zhvillimi Social
- Infrastruktura dhe Shërbimet Publike
- Qeverisja e Mirë

Një komunitet, shumë zëra

Komuna velipojë përbëhet nga shumë zëra – burra, gra, fëmijë, pleq, biznesmenë, fermerë e kështu me radhë. Ishte kritike për ne që të kuptonim shpesh se sa të ngjashme po aq dhe të ndryshme ishin nevojat dhe pritshmëritë e këtyre grupeve. Prosesi i PZHL inkurajoi pjesëmarrjen e grave në grupet e këshillimit, dhe të gjithë përfaqësuesit e komunitetit u ftuan që të merrnin pjesë në hartimin e këtij plani.

Komunikimi me publikun

Plani ynë i Zhvillimit Lokal është një bashkëbisedim me komunitetin. Ne morëm mendime dhe informacion nga komuniteti dhe shpresojmë që këto opinione janë të reflektuara në këto faqe. Ne kemi nevojë që të nxisim dialogun dhe opinionin e vazhdueshëm në mënyrë që të sigurohemi që po ndikojmë ashtu siç duhet tek komuniteti ynë.

Një panoramë më e gjërë

Plani i Zhvillimit Lokal i komunës Velipojë ka të bëjë me të menduarin në terma afatgjatë në lidhje me nevojat e zhvillimit të Velipojës. Sidoqoftë, ne u kujdesem që të merrnim parasysh edhe Strategjinë Rajonale të Zhvillimit të Qarkut Shkodër që të siguroheshim

që ishim në një linjë me Objektivat Rajonale dhe Kombëtare të Zhvillimit për Mijëvjeçarin. Në këtë mënyrë Plani i Zhvillimit Lokal i komunës Velipojë kontribon në arritjen e objektivave dhe prioriteteve kombëtare.

KUSH U PËRFSHI NË HARTIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT LOKAL


Për të pasur një proces të hapur dhe transparent, në hartimin e planit për zhvillimin e komunës Velipojë, është synuar një pjesëmarrje e gjërë nëpërmjet krijimit të grupeve të këshillimit me bazë pjesëmarrjen e komunitetit. Pjesëmarrja e tyre ishte kyç për suksesin e hartimit dhe zbatimit të PZHL.

Grupi i Planit të Zhvillimit Lokal (grupi PZHL): Ky grup është përgjegjës për nxitjen, udhëheqjen, këshillimin dhe mbikëqyrjen e hartimit të PZHL. Grupi i PZHL së Velipojës përfshiu 20 persona: kryetari i komunës, përfaqësues të keshillit të komunës, përfaqësues nga administrata e komunës, përfaqësues të fshatrave si dhe përfaqësues nga komuniteti.

Nënkomitetet e Fushave Prioritare: Këto grupe përfaqësojnë katër shtyllat kryesore (zhvillimi ekonomik, zhvillimi social, infrastruktura dhe shërbimet publike dhe qeverisja e mirë) dhe janë përgjegjës në përcaktimin e hapave të veprimit/projektet konkrete për fushat prioritare dhe hartimin e prefizibiliteteve dhe fizibiliteteve. Këto grupe mund të ftojne dhe specialistë të tjerë të jashtëm që të japin ekspertizen e tyre në detajimin e hapave të veprimit/projekteve konkrete.

Grupi i Monitorim-Vlerësimit me Pjesëmarrje (grupi MVP): Grupi i MVP-së ngarkohet të punojë ngushte me grupin e PZHL dhe nënkomitetet për të përcaktuar kriteret, vlerësuar procesin, caktuar matësat për realizimin e objektivave strategjikë apo hapave të veprimit. Grupi monitoron edhe zbatimin e PZHL dhe raporton sukseset apo pengesat tek qeverisja vendore (komuna dhe këshilli i komunës) dhe komuniteti. Grupi i MVP përbëhet nga 9 persona që përfaqësojnë administratën e komunës dhe komunitetin.

Figura 1. Diagrama që demonstroi lidhjen midis grupeve të këshillimit



SI E REALIZUAM KËTË PROCES? DHJETË HAPAT PËR HARTIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT LOKAL

1. Garantimi i angazhimit lokal. Ky hap siguron që zyrtarët e qeverisjes vendore dhe personeli të njihen me qëllimet e projektit dhe në të njëjtën kohë të angazhohen në këtë projekt. Me datë 20 qershor, u bë prezantimi i projektit në Këshillin e Komunës Velipojë. Gjatë këtij takimi u zgjodhën 3 anëtarë të këshillit si pjesëmarrës të grupit të PZHL.

2. Ofrimi i asistencës. Gjatë këtij hapi u orientuan dhe trajnuan anëtarët e grupit të PZHL dhe MVP për strukturën dhe metodologjinë e PZHL/MVP. Trajnimi 2 ditor u organizua më 27 – 28 korrik dhe përfshiu 27 pjesëmarrës.



3. Filimi i Punës. Grupet e PZHL dhe MVP organizuan takime gjatë të cilave caktoan planin e aktiviteteve që do të ndiqnin, si dhe caktoan afatet kohore, rolet dhe përgjegjësitë për çdo anëtar të grupeve. Gjithashtu u organizua një fushatë komunikimi që përfshinte fletëpalosje me informacion për projektin dhe postera për panairt e ideve në fshatra.

4. Mbledhja e informacionit. Përpara se të mësojmë se ku po shkojmë ne duhet të dimë se ku jemi. Ky hap na lejon të bëjmë një vlerësim të situatës aktuale të komunës dhe të krijojmë një pamje më të plotë dhe të saktë të komunës. Që këtu mund të fillojmë të mendojmë për të ardhmen e komunës. Kjo fazë ishte shumë e ngjeshur dhe kërkoi përkushtimin e grupit të PZHL si dhe të komunitetit. Për shembull, anëtarë të grupit të PZHL plotësuan pyetsorin prej 14 faqësh për karakteristikat e komunës – cilat janë burimet tona natyrore/njerëzore, buxheti i komunes e kështu me radhë. Këto të dhëna u morën në zyrat e komunës, në Qarkun Shkodër dhe në ndërmrrjet e tjera shtetërore.

Nëpunës të administratës së komunës dhe kryepleqtë e fshtarave realizuan anketimin e familjeve, gjatë të cilit u mor informacion nga komuniteti mbi shërbimet që ofron komuna. Anketimi u realizua në të 10 fshatrat e komunës. Familjet u zgjodhën në mënyrë të rastësishme në këto fshatra. Në të gjithë komunën u anketuan 200 familje.

Dhe së fundi, u realizua analiza SWOC me këshillin e komunës në takimin e radhës. Kryepleqt e fshatrave u përfshinë në këtë proces dhe dhanë mendime shumë të vlefshme. Analiza SËOC – Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Sfidat – lejoji të zgjedhurit lokale që të jepnin mendimet dhe opinionet e tyre për çfarë shkon mirë në komunë dhe çfare nuk shkon siç duhet, si dhe të bënin sugjerime se si mund të përmirësoheshin fushat prioritare.

5. Panairet e ideve në fshatra. Për të marrë opinionin e banorëve përveç anketimit u organizuan nga grupi i PZHL dhe Panairet e Ideve ne Fshatra. Panairet e Ideve në fshatra u cilësuan si forume interaktive për të grumbulluar idete dhe informacionet e banorëve dhe për ta përdor këtë informacion në hartimin e PZHL. Panairet e ideve u organizuan nga antarë të grupit lehtësues të PZHL dhe grupit të MVP, dhe kryepleqt e

SI MUND TE KONTRIBONI JU!

EDHE JU SI PJESE E KOMUNITETIT MUND TE KONTRIBUONI NE KETO PLANE ZVILLIM. MËSH HARRONI NE KETO PLANE KANE KUNDËR NE TE ARDHEMEN TUAJ DHE TE FSHATRE TUAJ.

KA DERA ELEMENTE TE PROCESIT QE MUND TE PËRPHIHEMI EDHE JU, SI:

PANAIRET E IDEVE NE FSHAT:

KETO PANAIRE JANE NE FORME DEMOKRATIKE DHE E HAPUR PER TE GRUMBULLUAR INFORMACION DHE OPINIONET TUAJA. ATO SHKRUHET NE SHKURTORE PERPHIJEJEN E 6 JERE DHE PËRFAJESIMIN E ZEMIT TE KOMUNITETIT NE KRUIJEN E VIZIONIT TE KOMUNES DHE PLANIT TE ZVILLIMIT LOKAL.

AMER NËN QË NEVILLAT TUAJA NE HIRE SE JU VETE QE JENE AFER PROBLEMEVE. DHE JU JENE ATA QE MUND TE OPRONI DHE HENRATA APO IDETE NE TE MIRA PER SULLIJE. MËSHINI PJESE NE KETO PANAIRE DHE NE KETE MENTRE KONTRIBUONI NE TE ARDHEMEN TUAJ!

Mbledhjet e hapura ne fshat:

NJE FORME TJETER PER HARRIEN E OPINIONIT TE KOMUNITETIT DHE DEBATIET DUE TE JENE DHE Mbledhjet e hapura QE DUE TE ZVILLONEN NEFER FSHATRA.

JU MUND TE BEHENI PJESE E KETRE Mbledhjeve DHE DEBATIET PER PROBLEME TE SHKURTISE QE KANE TE BEJNE ME PLANIN E ZVILLIMIT LOKAL.

ANKETIMI NE FSHAT:

NE KOMUNEN TUAJ JANE PERQJEDHUR RRETH 200 FAMILJE TE CLAT PO INTERVISTUORIN NE LIDHJE ME SHERBIET E OTRUARA MIRA KOMUNA. KETO ANKETIME PO REALIZOHEN MIRA VETE PËRFAJESIET E KOMUNES SUAJ.


JU LUTEM JANI TE HAPUR DHE BASHKËPUNONI ME INTERVISTUESIN NESE FAMILJA JUAJ ENKETE NJE MIRA, FAMILJET E PERQJEDHURIN BASHKËPUNONI PER INTERVISTEN.



fshatrave.

Panairet e ideve u organizuan në të 10 fshatrat, në vende të hapura, të përshtatshme dhe komode për pjesëmarrësit. Në komunën Velipojë morën pjesë në këto panaire më shumë se 250 pjesëmarrës nga të cilët 33 ishin gra dhe një numër i konsiderueshëm të rinjsh të cilët dhanë një informacion shumë të vlefshëm.

Figura 2: Konceptimi i Panairit të Ideve në Fshatra.



6. Sintetizimi i të dhënave. Me grumbullimin e të gjithë informacionit – profili i komunitetit, anketimi i familjeve, analiza



SËOC me këshillin e komunës, dhe panairët e ideve në fshatra - u përgatit nga një paketë informacioni për rishikim për anëtarët e grupit të PZHL dhe MVP. Duke pasur këtë informacion, grupi i PZHL-së Velipojë:

- a. Përcakttoi vizionin 10-15 vjeçar për komunën.
- b. Zgjodhi anëtarët për nënkomitetet e fushave prioritare
- c. Finalizoi objektivat strategjike për çdo fushë prioritare pas propozimeve të Nënkomiteteve të Fushave Prioritare
- d. Votoi për Vizionin dhe Objektivat Strategjike përfundimtarë.


7. Puna e nënkomiteteve të fushave prioritare. Ky hap përfshin planifikimin më në detaje të hapave të veprimit për çdo objektiv strategjik të fushave prioritare. Gjithashtu nënkomitetet u ngarkuan me detyrën e hartimit të prefizibiliteteve që të demonstrohej që hapat e veprimit dhe projektet ishin konkrete, kuptimplotë dhe të realizueshme. Takimet e katër nënkomiteteve të fushave prioritare u kryen në një periudhë kohore prej 3 javësh. Gjatë kësaj kohe grupi i monitorim vlerësimit me pjesëmarrje punoi me përcaktimin e indikatorëve të cilët u zgjodhën në bazë të aktiviteteve/projekteve që ishin përcaktuar nga nënkomitetet e fushave prioritare. E gjithë kjo punë u prezantua në grupin e PZHL i cili diskutoi planet e veprimit për çdo fushë prioritare, matjen e performancës si dhe hapat në vazhdim. Grupi i monitorim vlerësimit me pjesëmarrje bëri dhe një raportim mbi ecurinë e procesit si dhe sa mirë u arritën pritshmëritë e grupit të PZHL gjatë këtij procesi.

8. Ju Folët ne ju dëgjuam, a u kuptuam drejt? Takime me komunitetin dhe rishikimi i Këshillit të Komunës: në momentin që grupi i PZHL ka përfunduar draftin e PZHL, ne e prezantojmë atë në komunitet në mënyrë që të sigurohemi që kjo PZHL i përgjigjet nevojave të komunitetit. Kryepleqt e fshatrave luajnë rrol kryesor në këtë detyrë.

9. Integrimi me procesin e buxhetit. Qëllimi i PZHL-së është që t'i lejojë komunitetet që të drejtojnë dhe kontrollojnë të ardhmen e tyre. Megjithatë, kjo nuk mund të kuptohet e ndarë nga procesi i hartimit të buxhetit, pasi ky është momenti kur buxheti i limituar alokohet në ato zëra që ka më tepër nevojë komuniteti. Në hartimin e buxhetit, personeli i komunës paraqet zgjedhje konkrete dhe opsione për të zgjedhurit lokale se si mund të shpenzohen sa më efektivisht paratë e komunitetit. Duke pasur të dhënat dhe informacionin nga komuniteti, grupi i PZHL paraqet një panoramë për zgjidhjet e mundshme.

10. Zbatimi dhe Monitorim-Vlerësimi i vazhdueshëm. PZHL ka një plan të detajuar në të cilin janë përcaktuar edhe afatet kohore dhe përgjegjësitë. Grupi MVP është i ngarkuar me detyrën e monitorimit të progresit që bëhet për arritjen e rezultateve të matshme. Monitorimi do të bëhet rregullisht duke lejuar grupin e PZHL, të zgjedhurit lokale, dhe personelin e komunës që të bëjnë ndryshime të nevojshme atëhere kur nevojitet. Progresi do të raportohet edhe në komunitet me mënyra të ndryshme – media lokale, takime me këshillin e komunës, dhe postera.

Figura 3. Struktura e procesit të PZHL



CILI ËSHTË AFATI KOHOR PËR PLANIN E ZHVILLIMIT LOKAL?

PZHL përmabn plane veprimesh afatshkurtër dhe afatgjatë. Vizioni përfshin një periudhë kohore prej 10-15 vjetësh. Sidoqoftë, për të qënë sa me realistë dhe që të sigurohemi që gjërat bëhen në mënyrën që duam ne, e kemi ngushtuar hapësirën e veprimit në 5 vjet. Çdo hap veprimi që paraqitet më poshtë ka një afat kohor për zbatim. Përputhja me këto afate kohore do të monitorohet nga grupi i monitorim vlerësimit me pjesëmarrje.


Si ta lexojmë Planin e Zhvillimit Lokal.

Publikimi i Planit të Zhvillimit Lokal përmban këto seksione:

- **Hyrjen** në të cilën shpjegohen qëllimi, pjesëmarrja dhe metodologjia.
- **Profili i komunitetit** që shpjegon në detaje situatën aktuale të komunës duke u bazuar në të dhënat objektive të grumbulluara nga Grupi i PZHL dhe që plotësohet me opinione në lidhje me anketën e familjeve të organizuar në Gusht 2005..
- **Indikatorët e Performancës** për çdo fushë prioritare do të na lejojë që të monitorojmë progresin e bërë në arritjen e objektivave strategjikë.
- **Të Qënurit në një Drejtim** me Strategjinë Rajonale të Zhvillimit për Qarkun e Shkodrës tregon që velipoja po kontribon në strategjitë e zhvillimit rajonal dhe kombëtar.

Afatet kohore në të cilat u hartua Plani i Zhvillimit Lokal për Komunën velipojë

Shkurt	Velipopja u përzgjedh nga FZSHH si një nga 5 komunat pilot për të testuar metodologjinë e re të PZHL dhe MVP
17 Maj	FZSHH prezanton konceptin e PZHL tek Kryetari i Komunës dhe tek Administrata e Komunës
20 Qershor	Këshilli i Komunës voton pro për hartimin e Planit të Zhvillimit Lokal
27 – 28 Korrik	Grupi i PZHL dhe MVP trajnohen në një trajnim dy ditor.
5 – 9 Gusht	Në fshatrat Ças dhe Luarzë organizohen panairët e ideve
12 – 16 Gusht	Në fshatrat Mali Kolaj dhe Velipojë organizohen panairët e ideve
19 – 23 Gusht	Në fshatrat Baks – Rrjoll, Reç – Pulaj, Reç i Ri organizohen panairët e ideve
26 – 29 Gusht	Në fshatrat Pulaj – Plazh, Baks i Ri organizohen panairët e ideve
5 Shtator	Në fshatin Gomsiqe e Re organizohet panairi e ideve
Gusht	Përfundon grumbullimi i të dhënave nga anketimi i familjeve.
Shtator	Përfundon grumbullimi i të dhënave për profilin e komunës
31 Tetor	Organizohet analiza SWOC me Këshillin e Komunës dhe kryepleqt e fshatrave



KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME PËR KOMUNËN VELIPOJË

Komuna Velipojë është njësi administrative e Qarkut Shkodër. Ajo shtrihet në Veri të Shqipërisë dhe në jug të Shkodrës, ka një sipërfaqe prej 72,40 km² dhe në një distancë prej 25 km nga qyteti i Shkodrës. Në veri kufizohet me komunën e Dajçit, në jug me detin Adriatik, në lindje me prefekturën e Lezhës dhe në perëndim me lumin Buna, lum i cili e ndan nga Republika e Malit të Zi.



Komuna Velipojë nga pikëpamja e popullimit është një komunë relativisht e re pasi në mënyrë masive ka filluar të popullohet mbas viteve 60-të të shekullit të kaluar. Megjithatë të dhënat historike tregojnë që Velipoja njihet si vendbanim që në shek. XV, ekzistenca e mogilave (varreza në formë konike dhe të ndërtuara me gurë) të gjetura në Malin e Luarzit dhe në Majën e Zezë, rrënojat e kishës në breg të lumit Buna dhe gjetje të tjera arkeologjike e vërtetojnë më së miri këtë fakt. Komuna Velipojë përbëhet nga 10 fshatra dhe ka një popullsi prej 8270 banorë. Pozita e favorshme gjeografike ku ndërthuren deti dhe lumi, laguna dhe rezervati natyror, fushat pjellore, kënetat dhe pyjet, kodrat dhe malet i japin kësaj komune një mundësi të madhe për zhvillimin e turizmit detar, lumor dhe malor, të peshkimit dhe të gjuetisë, të zhvillimit të kulturave të ndryshme bujqësore dhe të blegtorisë.

Vendimi nr.682, datë 2.11.2005 që shpall lumin Buna dhe territoret ligatinore rreth tij “Peisazh ujor/tokësor i mbrojtur” ku hynë dhe ishulli i Franc Jozefit, rezervati i Velipojës, laguna e Vilunit, plazhi i Baks – Rrjollit dhe kënetat e Domnit është një tjetër avantazh për zhvillimin e turizmit në komunën Velipojë.

1. SHOQERIA (Kapitali Social)

a. Komuniteti dhe dinamika e tyre

Fshati	Nr. i banorëve		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Pulaj	538	544	1082
Velipoje	931	944	1875
Reç Pulaj	188	192	380
Luarz	291	293	584
Gomsiqe e Re	611	614	1225
Baks Rrjoll	273	271	544
Mali Kolaj	182	208	390
Baks i Ri	266	294	560
Reç i Ri	452	449	901
Ças	341	388	729
Komuna	4073	4197	8270

Në komunën Velipojë në ndryshim nga komunat e tjera të Qarkut Shkodër ku, mbas viteve 90-të ka pasur një lëvizje masive të popullsisë në drejtim të zonave urbane, lëvizje e cila ka ndikuar në uljen e popullsisë të këtyre komunave, në Velipojë një lëvizje e tillë është më e paktë. Megjithëse numri i familjeve nga viti 2000 në atë 2005 është rritur, do të vëmë re se në disa fshatra ka një rënie të numrit të familjeve. Kjo rënie e numrit të familjeve ndodh për shkak të emigrimit jashtë Shqipërisë, për shkak të lëvizjes në drejtim të qytetit, si dhe për arsye të lëvizjes në drejtim të fshatrave bregdetarë të komunës. Nga 8270 banorë që ka komuna Velipojë, përfitojnë pension 813 banorë ose 9,8%.

Nga këto, 380 vetë përfitojnë pension shtetëror (261 pension pleqërie, 25 pension invaliditeti dhe 94 pension familjarë) dhe 433 vetë përfitojnë pension kooperative (385 pension pleqërie, 11 pension invaliditeti dhe 37 pension familjarë). Megjithëse nuk ka të dhëna të sakta, llogaritet që forca aktive për punë të jetë rreth 50 %. Sipas të dhënave të Zyrës së Punës Shkodër numri i të punësuarve në sektorin publik është 103 nga ku

pjesa më e madhe punojnë në arsim dhe janë nga qyteti i Shkodrës. Nuk ka të dhëna për numrin e të punësuarve në sektorin privat si dhe për shkallën e papunësisë. Pjesa më e madhe e banorëve merren me bujqësi dhe blegtori, shume më pak në sektorin e ndërtimit. Emigracioni në shkallë komune është shumë i lartë gjë e cila tregon dhe për shkallën e lartë të papunësisë.

b. Arsimimi


Gjendja e sistemit arsimor në komunën Velipojë megjithë financimet që janë bërë për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e shkollave nga qarku dhe nga komuna, nuk është në nivelin e duhur. Numri i ambienteve për mësimdhënie dhe kushtet e tyre nuk mund të përballojnë numrin e nxënësve gjithnjë dhe në rritje. Komuna Velipojë ka 7 (shtatë) shkolla të arsimit 8 – vjeçarë dhe 1 (një) shkollë rë arsimit të mesëm. Numri i nxënësve që ndjekin arsimin shkollor është 1121 nga të cilët 917 vazhdojnë shkollën 8 – vjeçare dhe 204 vazhdojnë arsimin e mesëm. Aktiviteti i mësimdhënies mbulohet nga një personel arsimor prej 60 mësuesish nga të cilët 50 për arsimin 8 (tetë) vjeçarë dhe 10 për arsimin e mesëm.

Fshati	Nr. i familjeve në vite	
	2000	2005
Pulaj	182	281
Velipoje	249	459
Reç Pulaj	91	88
Luarz	132	138
Gomsiqe e Re	279	298
Baks Rrjoll	144	141
Mali Kolaj	145	108
Baks i Ri	152	144
Reç i Ri	255	232
Ças	181	167
Komuna	1987	2056

Figura 3. Shpërndarja e shkollave, nxënësve dhe mësuesve në komunën e Velipojes

Fshati	Shkollave 8-vjecare	Nxenes	Mesues	Shkollave te Mesme	Nxenes	Mesues
Velipojë	1	301	15			
Reç Pulaj	1	22	2			
Luarz	1	25	2			
Gomsiqe e Re	1	453	23	1	204	10
Baks Rrjoll	1	63	4			
Mali Kolaj	1	23	2			
Ças	1	30	2			
KOMUNA	7	917	50	1	204	10

Në panaiet e ideve të realizuara nëpër fshatra komuniteti shprehu interesin për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, përmirësimin e kushteve të ambienteve ku jepet mësim, paisjen e klasave me mjete mësimore si dhe në zgjidhjen e problemit të transportit të fëmijëve në shkolla.




Nga anketimi i realizuar me komunitetin në lidhje me gjendjen e shkollave rezulton se: 41,1% e të aneketuave janë “shumë të kënaqur” ose “të kënaqur” ndërsa 52,4% e tyre janë “të pakënaqur” ose “shumë të pakënaqur”. Një problem tjetër i vënë në dukje nga Drejtoria Arsimore Rajonale është

dhe braktisja e shkollës nga nxënës të arsmiit 8 – vjeçarë. Megjithatë në këtë drejtim është duke u punuar nga komuna, personeli arsimor dhe inspektorët e Drejtorisë Arsimore Rajonale për frenimin dhe zgjidhjen e problemit të braktisjes së shkollave. Përsa i përket arsimit parashkollor publik, mungon krejtësisht.

Dy kopshte që ndodhen në fshatrat Velipojë dhe Baks Rrjoll janë të ndërtuara nga prifti i komunës. Këto dy kopshte nuk mbulojnë nevojat e komunës, si pasojë fëmijët janë të detyruar të qëndrojnë në shtëpi. Në panaiet e ideve të realizuara banorët kanë shprehur shqetësimin e tyre për mosekzistencën e arsimit parashkollor publik. Nga anketimi rezulton se 71,1% e banorëve janë “të pakënaqur” ose “shumë të pakënaqur” nga gjendja e kushteve dhe çerdheve në komunë.

c. Kultura dhe koha e lire


Komuna Velipojë nuk ka një qender kulture, megjithëse në të kaluarën ka ekzistuar një e tillë. E vetmja qender kulturore që ndodhet në fshatin Velipojë është e ndërtuar dhe kjo nga prifti i komunës. E njëjta gjë vlen të theksohet dhe për qendrat sportive. Po ashtu



dhe dy qendrat sportive që ndodhen në fshatrat Velipojë dhe Baks Rrjoll janë të ndërtuara nga prifti i komunës. Banorët janë të pakënaqur nga mungesa e aktiviteteve kulturore ose sportive. Ato janë të pakënaqur dhe nga pamundësia për të kaluar kohën e lirë, pasi mungojnë parqet dhe lulishtet, këndet e lojrave si dhe të një biblioteke. Nga anketimi rezulton se 93,3% e të anketuarve janë “të pakënaqur” ose “shumë të pakënaqur” nga mungesa e aktiviteteve kulturore dhe 86,1% e të anketuarve janë “të pakënaqur” ose “shumë të pakënaqur” nga mungesa e aktiviteteve sportive.

d. Shërbimi shëndetësor


Shërbimi shëndetësor në komunën Velipojë është në varësi të Shërbimit Shëndetësor Parësorë. Ky shërbim përbëhet nga 2 (dy) qendra shëndetësore të cilat ndodhen në fshatin Gomsiqe e Re dhe në fshatin Pulaj Plazh. Gjithashtu në fshatin Velipojë ndodhet dhe një qendër shëndetësore private. Dy qendrat shëndetësore publike mbulohen nga një mjek dhe disa infermierë, numri i të cilëve është i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat e komunës. Mungesa e një personeli mjekësor të kualifikuar, e qendrave shëndetësore dhe ambulancave në fshatrat e tjerë të komunës, e një autoambulance, e



medikamenteve dhe e mjetëve të ndërhyrjes së shpejtë e vështirëson dhe më shumë problemin e shërbimit shëndetësor në komunë. Ndotja e ambientit, mungesa e kanalizimeve të ujrave të zeza dhe të një edukate higjieno – sanitare përbën një rrezik për përhapjen e sëmundjeve infektuese. Në panairët e ideve të realizuara nëpër fshatra banorët kanë shfaqur opinionet e tyre në lidhje me ndërtimin e qendrave shëndetësore nëpër të gjitha fshatrat, krijimin e një stafi mjekësor të kualifikuar dhe në vendosjen e koshave për hedhjen e mbeturinave në të gjitha lagjet. Nga anketimet rezulton se vetëm 22,2% e të anketuarve janë “shumë të kënaqur” ose “të kënaqur” me nivelin e pastërtisë të komunës në përgjithësi, ndërsa 27,9% e të anketuarve janë “shumë të kënaqur” ose “të kënaqur” me nivelin e pastërtisë në fshatrat e tyre.



e. Ndhma sociale

Niveli i lartë i papunësisë ndikon negativisht dhe në shtimin e familjeve që trajtohen me ndihmë sociale nga shteti. Nga të dhënat e zyrës së ndihmës sociale të komunës rezulton se 12% e familjeve të komunës Velipojë trajtohen me ndihmë sociale. Ndhimën sociale e përfitojnë familjet pa të ardhura, me të ardhura të pamjaftueshme dhe të paafitit. Në komunën Velipojë përfitojnë ndimë sociale 247 familje, nga të cilët 172 trajtohen me paftësi dhe 75 me ndihmë sociale. Zhvillimi ekonomik i zonës do të ndikojë në uljen e varfërisë dhe të numrit të familjeve që trajtohen me ndihmë sociale.



f. Cilësia e jetës


Megjithë papunësinë e lartë, të problemeve në lidhje me tokën dhe të mungesës së mekanikës bujqësore për punimin e saj, rezultojnë se 44,6% e të anketuarve përkrahin cilësinë e jetës në komunë "të mirë". Në lidhje me cilësinë e jetës në tre vitet e fundit, nga anketimi rezultojnë se 87,1% e të anketuarve pohojnë se cilësia e jetës




është "përmirësuar shumë" ose "përmirësuar disi". Por nuk duhet të harrojmë se në përmirësimin e cilësisë së jetës ndikon dhe numri i madh i emigrantëve, të cilët në pjesën më të madhe ndihmojnë me të ardhura familjet e tyre.

2. EKONOMIA

a. Situata e përgjithshme



Duke mos përjashtuar pozitën e favorshme gjeografike dhe burimet



e saja natyrore, komuna Velipojë ka një forcë aktive për punë të mjaftueshme për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Në komunë nuk ka të dhëna të sakta në lidhje me numrin e banorëve me arsim të lartë dhe të mesëm si dhe me punësimin dhe papunësimin e tyre. Afërsisht mendohet të jenë rreth 100 banorë me arsim të lartë, të cilët i përkasin profesionit të mësuesit, të agronomit, të zooteknikut, të veterinerit, shumë pak ekonomista dhe ndonjë inxhinier. Pjesa më e madhe e tyre janë të punësuar në sektorin privat (ndërtim, bujqësi, njësi tregtare), por nuk ka të dhëna pasi këto mungojnë si në Zyrën Rajonale të Punës ashtu dhe në komunë

b. Bujqësia

Pavarësisht vendodhjes së saj në breg të detit dhe mundësisë së zhvillimit të turizmit, për momentin bujqësia dhe blegtoria janë sektorët kryesorë të zhvillimit dhe të punësimin në Velipojë. Toka është pjellore dhe kjo i jep mundësi rritjes së të gjithë kulturave bujqësore të hershme dhe të vonshme. Prodhime tipike të zonës janë: domatet, patatet, shalqini, rrushi etj.

Por problemet e shumta në lidhje me ndarjen e tokës, ngastrat e vogla të sajë, çmimi i lartë për punimin e sajë, mungesa e mekanikës bujqësore, mungesa e njohurive dhe e prodhimit të produkteve të orientuara nga tregu si dhe infrastruktura e dobët rrugore ka ndikuar në një rendiment të ulët të prodhimeve bujqësore dhe të rënies e interesit për bujqësinë, gjë të cilën e tregon dhe sipërfaqja e madhe e tokës së papunuar.

Figura 12. Struktura e Tokes ne Komunen e Velipojes

Tokë Bujqësore (ha)				Pyje (ha)	Livadhe kullota (ha)
Ara (ha)	Pemishte (ha)	Ullishte (ha)	Vreshta (ha)		
2700	49	12	94	34	37

Figura 13. Prodhimet kryesore në Komunën e Velipojes

Drithëra		Produkte bujqësore		Vresht (t)
Grurë (t)	Misër (t)	Patate (t)	Fasule (t)	
680	239	19	13	138

Vlen të thkesohet se është duke u rritur ineteriei për ndërtimin e serave. Sipërfaqja aktuale e mbuluar me serë është 25750 m² dhe realizohet me ngrohje diellore.

c. Blegtoria

Në ndryshim nga bujqësia, blegtoria është më e zhvilluar kjo dhe për faktin e kostos më të ulët të shpenzimeve që bëhen në drejtim të saj si dhe të kullotave që ndodhen në komunë. Nga viti në vit është duke u rritur numri i krerëve dhe i produkteve blegtorale. Nga 2700 krerë gjedhë, 2050 janë lopë numër i cili ndikon në rritjen e sasisë së prodhimit të qumshtit, ndërsa nga 3100 krerë derra, 250 janë dosa dhe 2850 janë derra dhe gica.

Figura 14. Të Dhënat për Blegtorinë

Te imta		Gjedhë	Shpendë
Dhen	Të Dhirta		
3800	1050	2700	15100

Figura 15. Prodhimtaria e Blegtorisë në Velipoje

Delet		Dhitë		Lopët		Shpendët	
Mish	Qumësht	Lesh	Qumesht	Mish	Qumesht	Mish	Veze
844	3520	106	1485	1140	57890	96	1856

Nevojat e komunës për përpunimin e produkteve blegtorale. Mungesa e baxhove ka ndikuar që shpesh herë prodhimet blegtorale të shkojnë dëm. Gjithashtu është shfaqur

Në panaiet e ideve banorët kanë shprehur mendimin për ndërtimin e baxhove, pasi ato ekzistente nuk mbulojnë

dhe mendimi për ngritjen e fermave të vogla dhe i vënies në funksionim të komplekseve blegtorale në Ças dhe Reç i Ri, si dhe i organizimit të seminarëve për mbarështimin dhe përmirësimin racor.

Në një të ardhme të afërt prodhimet bujqësore dhe blegtorale të komunës do të jenë dhe furnizuesit kryesor të turizmit që është duke u zhvilluar.

d. Telekomunikacioni dhe Teknologjia Informuese

Në Velipojë ka një zyrë të shërbimit postarë (Gomsiqe e Re) si dhe një zyrë të shërbimeve telefonike (Gomsiqe e Re). Gjatë sezonit veror hapet dhe një zyre telefonike në Plazh. Ka vetëm dy numra telefoni publik, të cilët nuk mbulojnë nevojat e shumta që kanë banorët e komunës. Përveç telefonit publik është përhapur dhe ai privat që mbulon fshatrat Pulaj-Plazh, Velipojë, Gomsiqe e Re dhe Baks i Ri. Përhapje të gjërë po merr dhe rrjeti telefonik i kompanive Vodafon dhe AMC. Në disa fshatra të komunës përdoret gjërisht dhe rrjeti i telefonisë së lëvizshme të Malit të Zi, për arsyen e çmimeve shumë të ulta të bisedave.

Në panairët e ideve banorët kanë shprehur opinionin që të kenë një rrjet të telefonisë fikse që të mbulojë të gjithë komunën.

Përsa i përket shërbimit postar në komunë ekziston vetëm një postë. Nuk mund të flasim për Teknologji informuese pasi në Velipojë nuk ka asnjë linjë interneti apo kompjutera.

e. Turizmi



E ardhmja e Velipojës është turizmi. Pozita e favorshme gjeografike ku ndërthuren harmonishëm deti, lumi, pyjet, laguna dhe malet, i japin një siguri zhvillimit të turizmit. Plazhi me gjatësi 14 km gjërisht rreth 300 m, rëra e pashfrytëzuar dhe me aftësi shëruese si dhe uji i pastër po bënë që Velipojë të frekuentohet çdo vit e më tepër nga pushues të vendit dhe të huaj. Numri i pushuesve llogaritet rreth 50 mijë në sezon. Kapaciteti

	1. Përqindja e banorëve të kënaqur me cilësinë e ujit të pijshëm.	56 %	67 %	80 %	92 %
	2. Përqindja e banorëve të kënaqur me sasinë e ujit të pijshëm.	30,1 %	46 %	62 %	87 %
O.S	Indikatorët Sasior				
3.	1. Numri i kanaleve ujitës.	0	1	2	1
	2. Sipërfaqja e tokës nën ujë	0	200 ha	1400 ha	1650 ha
	3. Numri i familjeve përfituese	0	300	700	800
	Indikatorët Cilesor				
	1. Përqindja e banorëve të pakënaqur nga K.U.B	86,6 %	75 %	55 %	35 %
O.S	Indikatorët Cilesor				
4	1. Përqindja e popullsisë të kënaqur me pastertinë e komunës në teresi	22,2 %	40 %	60 %	80 %
	2. Përqindja e popullsisë të kënaqur me pastertinë e fshatit të tyre	27,9 %	45 %	65 %	85 %
O.S	Indikatorët Cilesor				
5.	1. Numri i fshtarave me trotuare dhe ndricim publik	0	1	3	5
	2. Numri i fshatrave me shërbim postar	1	1	2	2

Objektivi strategjik 1: Reabilitimi dhe mirembajtja e sistemit rrugor		
<p><i>Në reabilitimin dhe mirëmbajtjen e sistemit rrugor prioritet i komunës është asfaltimi i rrugës Gomsiqe e Re – Vorri i Hasanit – Cobaj e cila është e shtruar me çakull, asfaltimi i rrugës Vorri i Hasanit – Cas dhe asfaltimi i rrugës Mbisukë – Rec i Ri – Reç Pulaj shtruar pjesërisht me çakull dhe i rrugës Rruga nacionale – Varreza Pulaj si dhe në riparimin e rrugëve të lagjeve të fshatit Velipojë dhe të rrugëve të brendshme të fshatrave. I rëndësishëm është dhe studimi i rrugës Baks i Ri – Baks Rrjoll.</i></p>		
Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenim	Deri ne vitin
1. Asfaltimi i Gomsiqe e Re – Vorri i Hasanit – Cobaj, Vorri i Hasanit – Ças, Mbi Suke – Rec i Ri, dhe rruga nacionale – varreza Pulaj	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Bashkpunim me FSHZH per realizimin e projektit teknik te rruges ✚ Përfshirja e këtyre rrugëve në listen e objekteve prioritare për financim. 	2006 – 2007
2. Asfaltimi i pjesës së dytë të segmentit të rrugës së Mali Kolaj dhe të rrugës Reç i Ri – Reç Pulaj	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjëndjes ✚ Projekti teknik ✚ Përcaktimi i mekanizmit të financimit - komunikim me komunitetin, përfshirjen dhe kontributin e tyre në këto projekte, si dhe kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut për mundesi financimi. ✚ Prokurimi dhe ndërtimi 	2008
2. Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve: rruga nacionale – Qerret, rruga nacionale – shkolla Velipoje, rruga nacionale – lagje Shullej, rruga nacionale – lagje Prekaj, qendër Cas – lagje Selmanej.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjëndjes ✚ Projekti teknik ✚ Mekanizmi i financimit – komunikim me komunitetin, përfshirjen dhe kontributin e tyre ne keto projekte, përfshirja e projekteve në buxhetin vendor, si dhe kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut për mundësi financimi. ✚ Prokurimi dhe ndërtimi – 	2007 – 2010
4. Studimi i rrugës Baks i Ri – Baks Rrjoll.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjëndjes – Kush? Kur? Sa? ✚ Projekti teknik – Kush? Kur? Sa? ✚ Mekanizmi i financimit – Kush? Kur? Sa? ✚ Prokurimi dhe ndërtimi – Kush? Kur? Sa? 	2010

Objektivi strategjik 2: Reabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemit të ujësjellësit dhe K.U.Z		
<p><i>Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe ai i kanalizimeve të ujrave të zeza është një prioritet jo vetëm për rritjen përmirësimin e jetës dhe të kushteve higjieno – sanitare por dhe për vetë faktin se komuna është zonë turistike dhe me një frekuentim me pushues cdo vit dhe në rritje. Një gjë e tillë do të bëhet e mundu r nëpërmjet përfundimit të fzs së tretë të furnizimit me ujë, ndërtimin e një uijësjellësi të ri, riparimin e zonave të dëmtuara dhe ndërtimin e kanaleve të ujrave të zeza për fshatrat, Rec i Ri, Cas dhe Sektor</i></p>		
Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenim	Deri ne vitin:
1. Përfundimi i fazës së tretë të furnizimit me ujë për fashtrat: Gomsiqe e Re, Cas dhe Pulaj Plazh.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Bashkëpunim me komunitetin ✚ Bashkëpunim qeverisjen qendrore ✚ Bashkëpunim me donatorë 	2006 e në vazhdim

2. Ndërtim ujësjellësit në fshatin Baks Rrjoll	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjëndjes ✚ Projekti teknik ✚ Mekanizmit të financimit ✚ Prokurimi dhe ndërtimi 	2010
3. Ndërtimi i kanalizimeve të ujrave të zeza për fshatrat Reç i Ri.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjëndjes ✚ Projekti teknik ✚ Bashkëpunim me FZSH për financim. ✚ Përfshirja e këtij projekti në listën e objekteve prioritare për financim 	2006 – 2007
4. Ndërtimi i kanalizimeve të ujrave të zeza në fshatrat Cas dhe Sektor	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjëndjes ✚ Projekti teknik ✚ Mekanizmi i financimit – komunikim i vazhdueshëm me komunitetin përshirjen dhe kontributin e tyre në këto projekte, përfshirja e projekteve në buxhetin vendor, si dhe kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut për mundësi financimi. ✚ Prokurimi dhe ndërtimi 	2007 – 2008
4. Ndërtimi i kanalizimeve të ujrave të zeza për të gjithë komunën	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjëndjes ✚ Projekti teknik ✚ Mekanizmi i financimit – komunikim i vazhdueshëm me komunitetin përshirjen dhe kontributin e tyre në këto projekte, përfshirja e projekteve në buxhetin vendor, si dhe kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut për mundësi financimi. ✚ Prokurimi dhe ndërtimi 	2009 e në vazhdim

Objektivi Strategjik 3: Reabilitimi i sistemit ujtar dhe kullues

Reabilitimi dhe ndërhyrja në sistemin vaditës dhe kullues të dëmtuar dhe të papastruar, do të ndikonte pozitivisht në mospërmbytjen e tokave dhe në ruajtjen e rritjen rendimentit të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale dhe në mbrojtjen e ambientit. Prioritet është vënia në funksionim e kanaleve ujtarë Cas dhe Mertemze-Pentar. Do të synohet dhe në pastrimin e kanaleve kulluese të treta dhe të një studimi të ri për kullimin e tokave.

Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenim	Deri në vitin:
1. Rikonstruksioni i rrjetit ujtar Ças dhe Mertemze-Pentar	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjëndjes ✚ Projekti teknik – Bordi i Kullimit Shkodër ✚ Mekanizmi i financimit – bashkëpunim me komunitetin, pushteti vendor, Ministria e Bujqësisë, Keshilli i Qarkut, donatorë të huaj. ✚ Prokurimi dhe ndërtimi: kush? kur? sa? 	2008 e në vazhdim
2. Studim për kullimin e tokave.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjëndjes ✚ Projekti teknik – Instituti i Studimit të Tokave 	2008 e në vazhdim
3. Riparimi, pastrimi dhe vendosja në kuotë e argjinatrave mbrojtëse të	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjëndjes – kush? kur? sa? ✚ Projekti teknik – Bordi i Kullimit Shkodër ✚ Mekanizmi i financimit – bashkëpunim me komunitetin, pushteti vendor, Ministria e Bujqësisë, Keshilli i 	2008 e në vazhdim

komunës. Argjinaura e Vilunit, Pentar – Luarzit, Reç – Pulaj dhe e Çasit	Qarkut, donatorë të huaj. ✚ Prokurimi dhe ndertimi	
4. Pastrimi dhe vënia në funksionim e kanaleve kullese të treta.	✚ Vlerësimi i gjendjes ✚ Projekti teknik – Bordi i Kullimit Shkodër ✚ Mekanizmi i financimit – bashkëpunim me komunitetin, pushteti vendor, Ministria e Bujqësisë, Keshilli i Qarkut, donatorë të huaj.	2008 e në vazhdim
5. Rikonstruksioni i rrjetit ujitës Mertemze – Pulaj dhe ai parabolik.	✚ Vlerësimi i gjendjes ✚ Projekti teknik – Bordi i Kullimit Shkodër ✚ Mekanizmi i financimit – bashkëpunim me komunitetin, pushteti vendor, Ministria e Bujqësisë, Keshilli i Qarkut, donatorë të huaj.	2010 e në vazhdim

Objektivi Strategjik 4: Përmirësimi i shërbimit të pastrimit dhe mbrojtjes së ambientit

Rritja e popullsisë në mënyrë të vazhdueshme, rritja e konsumit të produkteve ushqimore, shtimi i ndërtimeve dhe frekuentimi i madh i plazhit gjatë periudhës së verës e bën të domosdoshëm përmirësimin e shërbimit të pastrimit dhe të mbrojtjes së ambientit. Prioritet është vendosja e koshave për hedhjen e mbeturinave në cdo fshat të komunës dhe pastrimi i zonës së mbrojtur nga mbeturinat e hedhura.

Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenim	Deri ne vitin:
1. Vendosja në numër të mjaftueshëm të kontenjerëve për hedhjen e mbeturinave në çdo fshat dhe lagje të komunës.	✚ Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit për hedhjen e mbeturinave në vendin e duhur (postera, fletë palosje, takime me banorët). ✚ Mbledhja e taksës së pastrimit nga ana e komunës për komunitetin dhe bizneset ✚ Vendosja nga Këshilli i Komunës i masave administrative për kundravajtësit që dëmtojnë kontenjerët dhe ndotin ambientin. ✚ Përcaktimi i vendodhjes për hedhjen e mbeturinave inerte	2006 – 2007
2. Pastrimi i zonave turistike (pyje, lagunë, lum dhe rërë) nga mbeturinat e hedhura pa kriter.	✚ Mekanizmi i realizimit të këtij projekti do të jenë – fondet e komunës, bashkëpunimi me komunitetin, me nxënësit e shkollave, me shoqatat për mbrojtjen e mjedisit. ✚ Do të kontaktohet dhe me Zyrën e Mjedisit pranë Këshillit të Qarkut dhe Shkodër dhe me Qëndren Rajonale të Mjedisit REC	2006
3. Rrethimi, pastrimi dhe hapja e koridoreve në rezervatin natyror, për ta mbrojtur nga zjarret, dëmtimet, ndotja dhe gjuetia e paligjshme.	✚ Vlerësimi i gjendjes - kush? kur? sa? ✚ Kontaktim me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave	2006 – 2008
4. Ndërtimi i një qëndre të mbrojtje kundër zjarrit në fshatin Pulaj – Plazh	✚ Ndërtimi i një qëndre të tillë bëhet i domosdoshëm jo vetëm për pyjeve të shumta por dhe për arsyen se stina e verës është shumë e nxehtë dhe është shkak për ndodhjen e zjarreve, si dhe të distancës nga Shkodra 32 km ✚ Përcaktimi i vendit ✚ Paisja me makina zjarrfikëse dhe mjetet e duhura logjistike ✚ Bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe donatorë të huaj	2008

5. Studim për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave nëpër fshatra.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjëndjes ✚ Kontakte me subjekte të licensuara ✚ Bashkëpunim me komunitetin 	2007
---	--	------

Objektivi 5: Shërbimeve të tjera publike		
<i>Qënia zonë turistike bën gjithashtu të domosdoshëm përmirësimin dhe të shërbimeve të tjera si sistemi i ndricimit publik, ndërtimi i trotuareve, ndërtimi i banjove publike në zonën e plazhit, zhvillimin e sistemit të telekomunikacionit dhe të rritjes së furnizimit me energji elektrike. E gjitha kjo duke ribërë studimin urbanistik të zonës bregdetare dhe planet rregulluese të fshatrave</i>		
Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenim	Deri ne vitin:
1. Ndërtimi i trotuareve dhe rrjetit të ndricimit publik rrugor në fshatin Gomsiqe e Re	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjëndjes ✚ Projekti teknik ✚ Bashkëpunim me FZSH për financim. ✚ Përfshirja e këtij projekti në listën e objekteve prioritare për financim 	2006
2. Ndërtimi i trotuareve dhe rrjetit të ndricimit rrugor në fshatrat Baks i Ri dhe Sektor	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjëndjes – komuna Velipojë ✚ Projekti teknik – komuna Velipojë ✚ Mekanizmi i financimit – komuna me fondet e veta dhe në bashkëpunim me komunitetin 	2007 - 2008
3. Bërja e ndriçimit të brendshëm publik për të gjithë fshatrat e komunës	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjëndjes – komuna Velipojë ✚ Projekti teknik – komuna Veliojpë ✚ Mekanizmi i financimit – bashkëpunim me komunitetin, fonde të komunës, buxheti i shtetit, donatorë. 	2007 e në vazhdim
4. Rikonstruksion dhe ndërtim banjosh publike në plazh	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Realizimi i këtij projekti do të bëhet me fonde të komunës dhe donatorë të ndryshëm.. 	2006
5. Përmirësimi i shërbimit të telefonisë fikse me anë të rritjes së numrave telefonikë dhe shtrirjes së tij në të gjithë fshatrat.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Kontakte me Alb – Telekom për rrije të numrave dhe shtrirje të rrjetit të telefonisë fikse ✚ Kontakte me shoqëri private për vendosje të rrjetit të telefonisë fikse 	2006 e në vazhdim
6. Përmirësimi i shërbimit të furnizimit me energji elektrike.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Kontakte me Drejtorinë Rajonale të KESH -it. ✚ Rritja e përqindjes së pagesës së enërgjisë elektrike 	2006 e në vazhdim
7. Realizimi i ndricimit publik në qendrat e fshatrave	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjëndjes – komuna Velipojë ✚ Projekti teknik ✚ Mekanizmi i financimit – bashkëpunim me komunitetin, me donatorë të huaj dhe forndet e komunës 	2008 e në vazhdim

Fusha Prioritare: Zhvillimi Social

Përmirësimi i jetës sociale të banorëve pavarësisht gjendjes së vështirë në të cilën ndodhet, është një tjetër synim i komunës Velipojë. Zhvillimi social është i lidhur ngushtë me përmirësimin e sistemit arsimor, të sistemi shëndetësor, të jetës sociale, kulturore dhe sportive dhe të kushteve higjienike dhe sanitare. Mungesa e klasave për të përballuar numrin e nxënësve në rritje, mungesa totale e çerdheve, kopshteve për fëmijët, e qendrave shëndetësore (një qender funksionale nuk mbulon nevojat për të gjithë komunën), mungesë e ambienteve sociale kulturore dhe sportive dhe e shoqatave e vështirëson jetën social kulturore të komunës. Për këtë arsye komuna Velipojë me anë të objektivave dhe prioriteteve të saja synon ndërtimin e shkollave të reja dhe ristrukturimin e atyre ekzistuese, ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve, ndërtimin e ambienteve kulturore dhe sportive, ndërtimin e qendrave shëndetësore dhe këshilluese.

Objektivi Strategjik 1: Përmirëmi i sistemit arsimor dhe parashkollor

Përmirësimi dhe forcimi i sistemit arsimor dhe parashkollor është kusht thelbësor për zhvillimin e komunës. Rikonstruksioni dhe përmirësimi i kushteve në shkolla ekzistuese, ndërtimi i shkollave, çerdheve dhe kopshteve, rritja e cilësisë së mësimdhënies, krijimi i mundësive për transport të fëmijëve në shkollë, krijimi i laboratorëve dhe hapja e një klase për degen e turizmit do të jenë dhe prioritetet e komunës Velipojë.

Objektivi Strategjik 2: Përmirësimi i sistemit shëndetësor

Ekzistenca e vetëm një qendre shëndetësore, nuk mbulon nevojat për shërbim mjekësorë. Prioritet i komunës do të jenë ndërtimi i qendrave shëndetësore në të gjithë fshatrat e komunës. Paisja me një ambulancë për transport të të sëmurëve, me medikamente dhe mjete të ndërhyrjes së shpejtë, forcimi i masave për parandalimin e sëmundjeve infektive dhe rritja e shërbimit të kualifikuar janë të tjera synime të komunës.

Objektivi Strategjik 3: Përmirësimi i jetës sociale kulturore dhe sportive

Përmirësimi i sistemit arsimor dhe shëndetësor është i lidhur ngushtë me zhvillimin e jetës sociale, kulturore dhe sportive. Për këtë synohet ndërtimi i ambienteve kulturore, i qendrave sportive, i ambienteve çlodhëse dhe parqeve, i një qendre interneti, i këndëve të lojrave për fëmijë, ngritja e grupeve artistike si dhe organizimi i aktiviteteve sportive, kulturore dhe sociale.

FUSHA PRIORITARE: Zhvillimi Ekonomik		STRATEGJI DHE PLANE KOMBETARE APO RAJONALE QE NDIKOJNE NE KETE FUSHE PRIORITARE				
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	1.Përmirësimi i sistemit arsimor dhe parashkollor	1. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik e Social 2. Strategjia Rajonale e Zhvillimit e Qarkut Shkodër				
	2.Përmirësimi i sistemit shëndetësor					
	3.Përmirësimi i jetës sociale, kulturore dhe sportive					
O.S	Hapat e veprimit	Koha e realizimit				
1.	Ndërtimi i shkollës në fshatin Mali Kolaj	2006 – 2007				
	Rikonstruksioni i shkollave në Ças, Baks Rrjoll	2007 e në vazhdim				
	Ndërtim çerdhesh dhe kopshtesh në të gjithë fshatrat e komunës	2006 – 2010				
	Hapja e një dege të turizmit pranë shkollës së mesme	2006 – 2007				
	Paisja e shkollave me paisje laboratorike	2006 – 2007				
	Rritja e cilësisë së mësim dhënies	E përvitshme				
2.	Ristrukturimi i qëndres shëndetsore në Gomsiqe	2007				
	Ndërtimi i qëndrave shëndetsore në të gjitha fshatrat	2007 e në vazhdim				
	Paisja me ambulancë për transportin e të sëmurëve	2007				
	Edukim shëndetsor dhe hartimi i politikave për parandalimin e sëmundjeve infektive	2007 e në vazhdim				
	Rritja profesionale e personelit dhe ofrimi i shërbimeve të kualifikuara	E vazhdueshme				
3.	Ndërtim biblioteke në fshatin Velipojë	2009 – 2010				
	Hapja e një qëndre interneti pranë shkollës së mesme	2008				
	Ngritja e qëndres kulturore dhe e grupit artistik të komunës në fshatin Gomsiqe e Re	2008 e në vazhdim				
	Ndërtim qëndrash sportive për të rinj	2007 – 2009				
	Ndërtimi i këndeve të lojrave për fëmijë dhe të ambienteve çlodhëse për pleqtë	2007 – 2010				
O.S	Indikatorët Sasiorë	Aktuale 2005	Synuar 2006	Synuar 2008	Synuar 2010	
1.	1. Numri i shkollave për arsimin 8 vjeçarë	11	1	1	1	
	2. Numri i ambienteve për arsimin parashkollor	0	1	2	2	
	3. Numri i fëmijëve në arsimin 8 vjeçar	546	600	700	820	
	Indikatorët Cilësor					
	1. Përqindja e banorëve të pakënaqur me gjëndjen e shkollave	52,4 %	45 %	35 %	20 %	
	2. Përqindja e banorëve të pakënaqur me gjëndjen e çerdheve dhe kopshteve	75,1 %	70 %	55 %	40 %	
	3. Përqindja e nxënësve që vazhdojnë shkollën e mesme					
	Indikatorët Sasiorë					

2.	1. Numri qëndrave shëndetsore	2	0	2	2
	Indikatorët Cilësor				
	1. Përqindja e banorëve të kënaqur me gjendjen e qëndrave shëndetsore	40,9 %	40,5 %	60 %	80 %
O.S	Indikatorët Sasiorë				
1.	1. Numri i qëndrave sportive	0	0	2	3
	2. Numri i qëndrave kulturore	0	0	1	1
	3. Numri i bibliotekave	0	0	0	1
	Indikatorët Cilësor				
	1. Përqindja e banorëve të pakënaqur me aktivitete sportive që zhvillohen	84 %	75%	60%	45%
	2. Përqindja e banorëve të pakënaqur me aktivitetet kulturore që zhvillohen	93,3 %	85%	70%	50%
	3. Përqindja e banorëve të pakënaqur me shërbimet që ofrohen për rininë në komunë	93,3 %	80%	65%	45%

Objektivi strategjik 1: Përmirëmi i sistemit arsimor dhe parashkollor		
<i>Përmirësimi dhe forcimi i sistemit arsimor dhe parashkollor është kusht thelbësor për zhvillimin e komunës. Rikonstruksioni dhe përmirësimi i kushteve në shkollë ekzistuese, ndërtimi i shkollave, çerdheve dhe kopshteve, rritja e cilësisë së mësimdhënies, krijimi i mundësive për transport të fëmijëve në shkollë, krijimi i laboratorëve dhe hapja e një klase për degen e turizmit do të jenë dhe prioritetet e komunës Velipojë.</i>		
Projektet/Hapat e Veprimt	Hapat Konkrete/Shenim	Deri ne vitin
1. Ndërtimi shkollë në fshatin Mali Kolaj	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjendjes ✚ Projekti teknik ✚ Përfshirja e këtij projekti në listën e objekteve prioritare për financim. 	2006 – 2007
2. Rikonstruksioni i shkollave në Ças, Baks Rrjoll	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Përfshirja e këtyre projekteve për tu financuar me fondet e komunës dhe të Keshillit të Qarkut 	2007 e në vazhdim
3. Ndërtim çerdhesh dhe kopshtesh në të gjithë fshatrat e komunës	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjendjes ✚ Projekti teknik ✚ Mekanizmi i financimit – bashkëpunim me qeverinë dhe me Keshillin e Qarkut, donatorë të huaj ✚ Prokurimi dhe ndërtimi 	2006 – 2010
4. Hapja e një dege të turizmit pranë shkollës së mesme	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Kontakte me drejtorinë e arsimit 	2006 – 2007
5. Paisja e shkollave me mjete laboratorike.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Bashkëpunim me komunitetin, Drejtorinë e Arsimit, Këshillin e Qarkut, donatorë dhe shoqata 	2006 – 2007
6. Rritja e cilësisë së mësimdhënies.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Kontrollë të vazhdueshme nga Drejtoria Arsimore ✚ Rritja profesionale e stafit arsimor 	E përvitshme

Objektivi strategjik 2. Përmirësimi i sistemit shëndetësor		
<i>Ekzistenca e vetëm një qendër shëndetësore, nuk mbulon nevojat për shërbim mjekësorë. Prioritet i komunës do të jenë ndërtimi i qendrave shëndetësore në të gjithë fshatrat e komunës. Paisja me një ambulancë për transport të të sëmurëve, me medikamente dhe mjete të ndërhyrjes së shpejtë, forcimi i masave për parandalimin e sëmundjeve infektive dhe rritja e shërbimit të kualifikuar janë të tjera synime të</i>		
Projektet/Hapat e Veprimt	Hapat Konkrete/Shenim	Deri ne vitin:
1. Ristrukturimi i qendres shëndetsore në Gomsiqe	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Rikonstruksioni do të realizohet me fondet e komunës dhe në bashkëpunim me komunitetin 	2007
2. Ndërtimi i qendrave shëndetsore në të gjitha fshatrat	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Realizimi i tyre do të bëhet në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Keshillin e Qarkut, donatorë të huaj, me pjesmarrjen e komunitetit dhe me fondet e komunës 	2007 e në vazhdim
3. Paisja me ambulancë për transportin e të sëmurëve	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Kontakte me Ministrinë e Shëndetësisë dhe donatorë 	2007

4. Edukim shëndetsor dhe hartimi i politikave për parandalimin e sëmundjeve infektive	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Takime dhe trajnime me grupe target te caktuara mbi parandalimin e sëmundjeve infektive dhe jo infektive, mbi planifikimin familjarë dhe edukaten seksuale, mbi kushtet higjieno sanitare. 	2007 e në vazhdim
5. Rritja profesionale e personelit dhe ofrimi i shërbimeve të kualifikuara	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Paisja e qëndres shëndetsore me medikamentet e nevojshme ✚ Kontrollë të vazhdueshme nga inspektoriat i shëndetsisë ✚ Trajnime të vazhdueshme të personelit dhe rritje të numrit të mjekëve dhe infërmierëve 	E vazhdueshme

Objektivi Strategjik 3: Përmirësimi i jetës sociale kulturore dhe sportive

Përmirësimi i sistemit arsimor dhe shëndetësor është i lidhur ngushtë me zhvillimin e jetës sociale, kulturore dhe sportive. Për këtë synohet ndërtimi i ambienteve kulturore, i qëndrave sportive, i ambienteve çlodhëse dhe parqeve, i një qëndre interneti, i këndëve të lojrave për fëmijë, ngritja e grupeve artistike si dhe organizimi i aktiviteteve sportive, kulturore dhe sociale.

Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenim	Deri ne vitin:
1. Ndërtim biblioteke në fshatin Velipojë	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjendjes – Komuna ✚ Projekti teknik ✚ Mekanizmi i financimit – bashkëpunim me komunitetin, Ministrinë e Arsimit, Këshillin e Qarkut, donatorë të huaj dhe me fonde të komunës ✚ Prokurimi dhe ndërtimi 	2009 – 2010
2. Hapja e një qëndre interneti pranë shkollës së mesme	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Realizimi i këtij projekti do të rriste interesin e nxësve për të hyrë në botën e kompjuterit dhe të zhvillimit global. ✚ Mekanizmi i financimit – donatorë dhe shoqata 	2008
3. Ngritja e qëndres kulturore dhe e grupit artistik të komunës në fshatin Gomsiqe e Re	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Ngritja e qëndrës do të gjallëronte jetën kulturore të komunës si dhe do të nxirrte në pah vlerat kulturore dhe traditën e kësaj zone ✚ Ngritja e grupit do realizohet mbi bazën e vullnetarizmit dhe të aftësive profesionale artistike të banorëve 	2008 e në vazhdim
4. Ndërtim qëndrash sportive për të rinj	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Gjallërimi i jetës së të rinjve është i lidhur ngushtë me ndërtimin e qëndrave sportive ✚ Vlerësimi i gjendjes ✚ Mekanizmi i financimit – bashkëpunim me komunitetin, donatorë të huaj dhe me fonde të komunës 	2007 – 2009
5. Ndërtimi i këndeve të lojrave për fëmijë dhe të ambienteve çlodhëse për pleqtë	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjendjes ✚ Mekanizmi i financimit – bashkëpunim me komunitetin, donatorë të huaj dhe me fonde të komunës 	2007 – 2010

Fusha Prioritare: Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë dhe shoqëria demokratike duhet të ndërtohen mbi institucione demokratike. Për këtë arsye administrata dhe Këshilli i Komunës Velipojë është duke u drejtuar nga principi i hapjes maksimalen ndaj publikut. Administrata do të synojë që të inkurajojë pjesmarrjen e banorëve, e grupeve të interesuar apo dhe të shoqatave në procesin e vendimmarrjes. Prioritet nuk do të jetë vetëm dhënia e informacionit të duhur komunitetit por, dhe marrja e informacionit nga komuniteti në mënyrë që ta kthejë këtë informacion në faktor për një qeverisje të mirë. Rritja e transparencës, rritja e aftësive profesionale të administratës vendore, krijimi i kushteve optimale për punë, rritja e nivelit përfaqësues të të zgjedhurve të popullit, forcimi i komunikimit në mes pushtetit vendor dhe komunitetit si dhe marrja e mendimit kritik të komunitetit për punën e komunës do të jenë të tjera synime për arritjen e qeverisjes së mirë

Objektivi Strategjik 1: Rritja e pjesmarrjes së komunitetit në vendimmarrje

Rritja e transparencës dhe e përfshirjes së komunitetit, e grupeve target dhe e shoqatave në vendimmarrje është dhe prioriteti kryesor. Takimet e përbashkëta në komunë apo dhe në fshatra, marrja e mendimit kritik për mbarëvajtjen e punëve, konsiderimi i publikut si burim për ide të mira, realizimi i broshurave dhe fletë palosjeve do jenë dhe hapat për realizimin e qeverisjes së mirë.

Objektivi Strategjik 2: Aftësi profesionale i administratës dhe e këshillit të komunës

Aftësi profesionale i administratës dhe i këshilltarëve është një tjetër objektivi për një qeverisje të mirë dhe një komunikim të drejtë me komunitetin dhe grupet e tjera të interesuara. Kryerja e trajnimeve dhe seminarëve mbi transparencën, kodin e sjelljes, mënyren e ofrimit të shërbimeve dhe të informacionit, paisja me bazën e duhur ligjore do të rrisin aftësitë profesionale të nëpunësve.

Objektivi Strategjik 3: Përmirësimi i kushteve të punës të administratës së komunës

Rritja e transparencës dhe profesionalizmit në punë dhe dhënia e duhur e informacionit janë të lidhura ngushtë me përmirësimin e kushteve të punës. Për këtë synohet paisja e të gjitha zyrave të komunës me kompjutera dhe me bazën e duhur logjistike, rikonstruksioni i godinës së komunës dhe krijimi i kushteve optimale për pritjen e banorëve. Hapja e zyrës së informimit për publikun dhe asaj sociale do të rrisin komunikimi, bashkëpunimin dhe zgjidhjen e problemeve të banorëve.

FUSHA PRIORITARE: Zhvillimi Ekonomik		STRATEGJI DHE PLANE KOMBETARE APO RAJONALE QE NDIKOJNE NE KETE FUSHE PRIORITARE			
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	1. Rritja e pjesmarrjes së komunitetit në vendimmarrje	1. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik e Social 2. Strategjia Rajonale e Zhvillimit e Qarkut Shkodër			
	2. Aftësimi profesional i administratës dhe e këshillit të komunës				
	3. Përmirësimi i kushteve të punës të administratës së komunës				
O.S	Hapat e veprimit	Koha e realizimit			
1.	Nxitja e komunitetit, grupeve target dhe shoqatave për të marrë pjesë në vendimmarrje	2006 e në vazhdim			
	Rritja e transparencës dhe e dhënies së informacionit	2006 e në vazhdim			
	Realizimi i takimeve të përbashkëta në komunë dhe në fshatra	2006 e në vazhdim			
	Komunikim të vazhdueshëm me mediat dhe shoqatat	2006 ne vazhdim			
2.	Trajnime dhe seminare për administratën, këshillin e komunës dhe kryepleqt e fshatrave	2006 e në vazhdim			
	Hartimi i rregullorë së funksionimit të administratës dhe të këshillit të komunës	2006 – 2007			
	Shkëmbim eksperience me komunë të tjera të bregdetit të Shqipërisë dhe të komunës Ulqin	2006 e në vazhdim			
3.	Paisja e të gjitha zyrave të komunës me kompjutera dhe bazën e duhur logjistike	2006			
	Rikonstruksioni i godinës së komunës	2006 - 2007			
	Hapja e sektorit social pranw komunws	2006 – 2007			
	Hapja e zyrës së informimit për publikun pranw komunws	2006 – 2007			
O.S	Indikatorët	Aktuale 2005	Synuar 2006	Synuar 2008	Synuar 2010
1.	1. Përqindja e banorëve të interesuar për vendimmarrjen dhe sa marrin pjesë në qeverisjen lokale	31,6 %	35 %	45 %	60 %
	2. Përqindja e banorëve që i përgjigjen pozitivisht pyetjes mbi dobishmërinë e informacionit.	58 %	65 %	75 %	88 %
O.S	Indikatorët				
2.	1. Përqindja e banorëve të kënaqur me sjelljen e nëpunësve të komunës.	39,4 %	45 %	65 %	85 %
	2. Përqindja e banorëve të kënaqur me kryerjen e shërbimit në përgjithësi	36,3 %	40 %	55 %	75 %

Objektivi strategjik 1: Rritja e pjesmarrjes së komunitetit në vendimmarrje		
<i>Rritja e transparencës dhe e përfshirjes së komunitetit, e grupeve target dhe e shoqatave në vendimmarrje është dhe prioriteti kryesor. Takimet e përbashkëta në komunë apo dhe në fshatra, marrja e mendimit kritik për mbarëvajtjen e punëve, konsiderimi i publikut si burim për ide të mira, realizimi i broshurave dhe fletë palosjeve do jenë dhe hapat për realizimin e qeverisjes së mirë.</i>		
Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenim	Deri ne vitin
1. Nxitja e komunitetit, grupeve target dhe shoqatave për të marrë pjesë në vendimmarrje	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Pjesmarrja e publikut përdoret si burim për ide të mira ✚ Pjesmarrja nxjerrë në pah cilësitë e banorëve që mund të jenë nëpunësit ose të zgjedhurit e ardhshëm të komunës ✚ Pjesmarrja e publikut i jep mbështetje politikave dhe vendimeve që nxjerr keshilli i komunës ✚ Vendosja pranë komunës e një kutie postare ku banorët mund të hedhin mendimet dhe opinionet e tyre të shkruara dhe në formë anonime 	2006 e në vazhdim
2. Rritja e transparencës dhe e dhënies së informacionit	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Organizimi i seminareve mbi të drejtën për informim (URI, GTZ, USAID, QZHDI) ✚ Publikimi i vendimeve, urdhërësive, tarifave në qënder të komunës 	2006 e në vazhdim
3. Bërja e broshurave, fletë palosjeve dhe e një newsletter	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Komuna me fondet e veta apo dhe me ndihmën e shoqatave mund të realizojë botimin e broshurave dhe të fletë palosjeve për buxhetin e komunës, masat administrative për kundra vajtësit, tarifat për kryerjen e shërbimeve etj. ✚ Publikimi periodikisht i një newsletter i komunës. 	2006 e në vazhdim

Objektivi strategjik 2. Aftësimi profesional i administratës dhe e këshillit të komunës		
<i>Aftësimi profesional i administratës dhe i këshilltarëve është një tjetër objektivi për një qeverisje të mirë dhe një komunikim të drejtë me komunitetin dhe grupet e tjera të interesuara. Kryerja e trajnimeve dhe seminarëve mbi transparencën, kodin e sjelljes, mënyren e ofrimit të shërbimeve dhe të informacionit, paisja me bazën e duhur ligjore do të rrisin aftësitë profesionale të nëpunësve.</i>		
Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenim	Deri ne vitin:
1. Trajnime dhe seminare për administratën, këshillin e komunës dhe kryepleqt e fshatrave	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Kontakte me Departamentin e Administratës Publike, GTZ, URI, USAID etj ✚ Përmirësimi i etikës në shërbimin civil, mënyra e dhënies së informacionit dhe e kryerjes së shërbimeve me cilësi dhe në kohën e duhur. 	2006 e në vazhdim
2. Hartimi i rregullorës së funksionimit të administratës dhe të këshillit të komunës	✚ Administrata e komunës dhe USAID	2006 – 2007
3. Shkëmbim eksperience	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Kontakte me komuna të tjera të bregdetit të Shqipërisë ✚ Kontakte dhe shkëmbim eksperience me komunën e Ulqinit (Mali i Zi) 	2006 e në vazhdim

Objektivi Strategjik 3: Përmirësimi i kushteve të punës të administratës së komunës

Rritja e transparencës dhe profesionalizmit në punë dhe dhënia e duhur e informacionit janë të lidhura ngushtë me përmirësimin e kushteve të punës. Për këtë synohet paisja e të gjitha zyrave të komunës me kompjutera dhe me bazën e duhur logjistike, rikonstruksioni i godinës së komunës dhe krijimi i kushteve optimale për pritjen e banorëve.

Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenim	Deri ne vitin:
1. Paisja e të gjitha zyrave të komunës me kompjutera	✚ Paisja e zyrave do të bëhet në bashkëpunim me Qëndren për Zhvillim dhe Demokratizim te Institucioneve QZHDI.	2006
2. Paisja e zyrave me materiale te tjera logjistike	✚ Komuna me fondet e veta dhe në bashkëpunim me shoqata	2006 - 2007
3. Hapja e zyrës së informimit për publikun	✚ Hapja e një zyre të tillë është një domosdoshmëri pasi rrit kontaktet e administratës së komunës me komunitetin dhe mundësi për dhënie dhe marrje informacioni. ✚ Paraqitja pranë Këshillit të Komunës për aprovim	2006 – 2007
4. Hapja e sektorit social	✚ Problemet e ndryshme sociale, me të paaftë, invalidë apo të verbër është një tjetër sektor që duhet ti shtohet strukturës së administratës së komunës. ✚ Paraqitja pranë Këshillit të Komunës për aprovim ✚ Hartim projektesh ✚ Bashkëpunim me shoqata	2006 – 2007
4. Rikonstruksioni i godinës	✚ Komuna me fondet e veta	2006 - 2007